

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti dhënies në përdorim: Bashkia Elbasan, adresa: Rr. “Qemal Stafa”, nr.tel/fax:(+355)54 400152, e-mail : bashkiaelbasan@elbasani.gov.al.
2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja e fondit pyjor prej 1 ha, të ndarë në lote:
 - Loti i parë: Për sasinë totale prej 1 (një) ha në n/ngastrën pyjore nr.19/a (d) me nr. pasurie 275, Zk 1742 ekonomia pyjore “Gjinar-Zavalinë”.
3. Qëllimi i dhënies në përdorim:
 - Loti i parë: Për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje.
4. Afati i dhënies në përdorim: është 9 (nëntë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
5. Vlera dysheme për detyrimin e përdorimit e ndarë në lote:
 - Loti i parë: 110,000 (njëqind e dhjetëmijë) Lekë/vit, pa T.V.SH.
6. Vendi i Zhvillimit të Konkurimit: Konkurimi për marrjen në përdorim do të kryhet në ambjentet e Bashkisë Elbasan, pranë zyrave të Agjencisë së Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit (APBM), kati III. Dokumentat standard të konkurimit tërhiqen në adresën e sipërcituar.
7. Vleresimi i ofertave konkurrese do të bëhet me pikë si vijon:
 - projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me

koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;

- planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
- masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar, për secilin lot më vehte, në dokumentet standarde të konkurimit.
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- d) në rastin e personave fizik dokumenti original i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.
- e) vërtetim nga prokuroria, gjykata, Drejtoria Rajonale Tatimore, Taksat Vendore.
- f) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes.
- g) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV_në profesionale të tregohet provoja në fushën e veprimtarisë.

9. Dokumentacioni i nevojshëm:

- a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- c. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- d. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- e. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes nëse është i zbatueshëm;
- f. Nivelin e punësimit në veprimtari;
- g. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- h. Adresën e subjektit, telefon, e-mail dhe faks;

10. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie përdorim”, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurimit.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues.

Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.

Data e zhvillimit të konkurimit: 17.07.2024, ora 10:00, në ambientet e Bashkisë Elbasan, pranë zyrave të Agjencisë së Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit (APBM), kati III.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 17.07.2024, ora 10.00.